# DËSHMI ARKIVI

**A-473681**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet! |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/enveri-perfundoi-ne-dulle-dhe-rama-ne-ramzi-fundi-i-njejte-mbetet-i106292` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 12:14:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 12:05:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `afdea5dfe20baf5f042cd4fd499cb4cdb42830b2150577df6caa76dffaf7c5f9` |
| TEKSTI | `a668418afb5cad26c584cad200225ee544ab57a7e2de8bb7634daa64fae05993` |
| PAMJA | `e0648a70432922849c7e2db33912203e6525ee40953909f84f51c6c926437e12` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `02da14c2912054137bfccd6f235faf72f2e79e3c8fa4dda98859988df7122b55` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7677d8d9488aa5a9422459265187ef4d7802fbf31e13dbd8fed410ad19a65ead` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/02da14c2912054137bfccd6f235faf72f2e79e3c8fa4dda98859988df7122b55`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet!

Nga Petrit Vasili Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 14:05



Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet!

Asnjë shqiptar nuk mund të harrojë që gjatë diktaturës shqiptarët i vunë Enver Hoxhës nofkën Dulla.

Qytetarët, kur flisnin me njëri-tjetrin, përdornin emrin "Dulla" si një emër të koduar satirik ose përçmues për ta tallur atë dhe për të anashkaluar survejimin brutal dhe mizor të Sigurimit të Shtetit.

E quanin "Dulla" si një formë rezistence në një kohë kur të folurit kundër udhëheqjes ose regjimit të urryer komunist mund të shkaktonte burgosje të rëndë politike ose internim të gjithë familjes.

Fundi i Dullës ishte ai që shqiptarët vendosën në fund të viteve '90 dhe që solli pluralizmin.

Ndërsa sot një Dullë i ri, qesharak, i paditur, primitiv dhe ordiner po tenton të shfaqet dhe ky është Edi Rama ose, shkurt, Ramzi.

E kanë pagëzuar Ramzi, sepse sjellja, portreti dhe veprimet e tij ngjallin vetëm zi.

I trashë në çdo sjellje, Ramzi ka shndërruar politikën dhe detyrën e misionin e saj në një pazar fshati, ku blen e shet çdo gjë, ku parimet, morali dhe ligji nuk ekzistojnë.

Për Ramzin blerja dhe vetëm blerja ekziston dhe në imagjinatën e tij e gjithë shteti dhe shoqëria është një pazar i madh i gjësë së gjallë, ku kryeshitblerësi është vetë Ramzi.

E gjithë kjo shpjegon zvarritjen e neveritshme të Ramzit dhe ecjen këmbadoras të tij nëpër baltovinën e korrupsionit shtetëror dhe moralit më të turpshëm që ky vend ka parë.

Për Ramzin koha për t'u shporrur ka ardhur me kohë e me vakt, por, si të gjithë ata që kanë vetëm diktaturën në kokë si qëllim dhe objektiv të jetës së tyre, largimi është një version i pamundur.

Statujën e Dullës në mes të sheshit qytetarët e bënë copa-copa, së bashku me të edhe të gjithë regjimin gjakatar që ai ngriti.

Ndërsa sot Ramzi, kjo fytyrë e urryer, e bezdisur dhe e pështirë për shqiptarët, nuk po largohet, por po zhgarravitet nëpër shesh, duke u përpjekur të shpikë fije bari për t'u kapur.

Ramzi po bën gjithçka për të ikur në mënyrën më të turpshme, sepse mënyrë dinjitoze sigurisht që ai nuk njeh

Ramzi po bën gjithçka për të ikur në mënyrën më të turpshme, sepse mënyrë dinjitoze sigurisht që ai nuk njeh.

Ramzi nuk rri dot më në pushtet, se ju ka dalë tepër të gjithëve, megjithatë ai zvarritet pas brekëve të banditëve dhe narkotrafikantëve, me shpresë se do të shtyjë ca kohë, ca minuta, ca sekonda.

E sigurt në mënyrë absolute është që, ashtu si Dulla dhe Ramzi, fundin e kanë njëlloj dhe të pashmangshëm, ashtu si edhe turpin e përjetshëm për atë që i bënë këtij vendi.

Dulla ishte pak më me fat, se vdiq pak përpara se të shihte fundin e tmerrshëm, ndërsa Ramzi jo, nuk e pati këtë fat, ndaj e ardhmja e këtij të fundit duket të jetë shumë më e keqe.

Po Ramzi, fundin e tij mizabel e zgjodhi vetë, ndaj le ta gëzojë.....!

## Artikuj te sugjeruar

Nga Belind Këlliçi POLITIKE 27 Shtator13:56

**Fjalimi në OKB/ Këlliçi: Rama akuzoi shqiptarët për antisemitizëm - do mbahet mend se ktheu Shqipërinë në narkoshtet**

Miqtë e mi, Ju ftoj të ndiqni një pjesë të fjalimit të Edi Ramës në OKB. Këtë fjalë zgjodhi Edi Rama ...

POLITIKE 27 Shtator13:50

**Stadiumi jehoi me thirrje kundër Ramës, Bardhi: Në Shqipëri, diasporë, sheshe e shkolla ka vetëm një thirrje, shporru!**

Fitorja e Shqipërisë ndaj Bjellorusisë solli jo vetëm entuziazëm dhe gëzim te tifozët, por u përcollën edhe mesaz...

POLITIKE 27 Shtator10:31

**Ish zv.ministri i Arsimit: Rama nuk u pranua në takimet e nivelit të lartë në New York**

Ish-zv.ministri i Arsimit, Oltion Rrumbullaku ka komentuar qëndrimin e kryeministrit Edi Rama në Nju Jork, gjatë zhvillimit të punimeve t&...

POLITIKE 26 Shtator21:54

**Kush e përzgjodhi dhe verifikoi Vlora Hysenin? Ish-ministrja socialiste, Meksi, reagon për skandalin e SHISH**

Ish-ministrja dhe ish-deputetja Ermelinda Meksi ka reaguar përmes një postimi në Facebook lidhur me çështjen e Vlora Hysenit. Meksi ...

POLITIKE 26 Shtator21:47

**Thirrja "urgjente"/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasi pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet**

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t'u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

POLITIKE 26 Shtator21:15

**Nga vezët e protestuesve te torta me flamingo, Rama batuta para diasporës në Nju-Jork**

Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit me diasporën shqiptare në Nju-Jork, foli për një ndryshim në marrëdhënien mes ...

POLITIKE 26 Shtator19:48

**"Brenda SPAK ka përplasje për Vlora Hysenin", gazetari: Ai dhe një gjyqtar i GJKKO ka qenë në zyrën e Ergys Agasit**

Prokurori i dosjes së AKSHI-t, Altin Dumani është në një konflikt me një prokuror të SPAK për llogari të dosjes s&e...

POLITIKE 26 Shtator19:01

**"Nis mbledhja e firmave për referendum për bashki"/ Zhupa nga Ksamili: Kërkojmë të respektohet vullneti dhe nevojat e qytetarëve**

Drejtuesja politike e Partisë Demokratike për rrethin e Sarandës, deputetja Ina Zhupa, ka bërë të ditur nisjen e mbledhjes së...

POLITIKE 26 Shtator18:41

**Aktivistja 'masakron' deputetin: Erion Braçe o karton, ça thotë shefi ti voton**

Aktivistja Arvina Lleshi ka 'shenjëstraur' sërish deputetin e PS, Erion Braçe, teksa tanimë socialistët janë v&eum...

POLITIKE 26 Shtator17:33

**'Disa histori i kam jetuar, ka shumë për të thënë'/ Çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri? Publikon videon 'enigmatike'**

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, ka surprizuar me postimin e tij të fundit në rrjetet sociale. Në postimin e tij, Tahiri shkruan:...

## ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 26 Shtator

[Thirrja "urgjente"/ Rama mesazh shqiptarëve nga...]

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t'u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

AKTUALITET 26 Shtator

[Autobusi përfshihet nga flakët në hyrje të tune...]

Një autobus është përfshirë nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan. Për shkak të incidentit, rruga &e...

AKTUALITET 26 Shtator

[Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit ...]

Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për "vrasje të funksionarëve publikë për shkak të d...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!]

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.